

Për:	Grup i Operatorëve Ekonomik: “PRO MEDICAL” Sh.p.k. & “Adnan A. Bala’ B.I. me adresë në Ferizaj Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	30.04.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: 27.04.2020, të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “PRO MEDICAL” Sh.p.k. & “Adnan A. Bala’ B.I. me adresë në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR FIZIOTERAPI PËR NEVOJA TË QKMF – së**, me Numër të prokurimit: 623-20-1053-1-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-008-1-2-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** si e pa bazuar kërkesa të parashtruar nga Grup i Operatorëve Ekonomik: “PRO MEDICAL” Sh.p.k. & “Adnan A. Bala’ B.I. me adresë në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR FIZIOTERAPI PËR NEVOJA TË QKMF – së**, me Numër të prokurimit: 623-20-1053-1-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-008-1-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 24.04.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR FIZIOTERAPI PËR NEVOJA TË QKMF – së**, me Numër të prokurimit: 623-20-1053-1-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-008-1-2-1, dhe mbështetë Vendimin e miratuar nga Autoriteti Kontraktues.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik: “PRO MEDICAL” Sh.p.k. & “Adnan A. Bala’ B.I. me adresë në Ferizaj, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: FURNIZIM ME PAISJE MJEKËSORE PËR FIZIOTERAPI PËR NEVOJA TË QKMF – së, me Numër të prokurimit: 623-20-1053-1-2-1, Nr. i brendshëm: 623-20-008-1-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 24.04.2020, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 27.04.2020, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për refuzim të kërkesës

Autoriteti Kontraktues hedh poshtë pretendimin e OE dhe njëherit konfirmon se A.K Komuna e Rahovecit ka vepruar duke u bazuar së pari në Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik.

Me datë: 24.04.2020, jeni njoftuar duke i cekur arsyetim se tenderi juaj është refuzuar për këto arsye, referohu formularit: ***B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar.***

Autoriteti Kontraktues ka vepruar sipas A01 Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik, Neni 18, parag. 18.3 thotë: *Të gjitha çmimet e specifikuara në tender duhet të deklarohen në Euro (€). Çmimi i ofertuar lejohet që të shënohet me maksimum dy (2) numra pas pikës dhjetore. Nëse OE ofron çmim me me shume se dy (2) numra pas pikës dhjetore, oferta e tille do të konsiderohet e papërgjegjshme.*

Komisioni Ri-vlerësues duke u bazuar në shkresat e lëndës të cilat i ka pas në dispozicion, vjen në përfundim se oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme, pasi që tek Përshkrimi i çmimeve keni ofruar tek Çmim për njësi më shumë se dy (2) numra pas pikës dhjetore.

Autoriteti Kontraktues ka vendosur që dokumentacione dhe informacione shtesë të mos kërkojë për dokumentet tjerra, pasi që oferta juaj administrativisht është e papërgjegjshme apo e eliminuar sipas Ligjit të Prokurimit Publik dhe RrUOPP-së.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Astrit Mullabazi
Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Komuna e Rahovecit